




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 280 Prot

Nr. 1802/1 Dosje

Tiranë, më 15.02.2019

**URDHËR**

**PËR VENDOSJEN E MASËS SË SIGURIMIT**

**Drejtuar : Qendra Kombetare e Biznesit**

**Per Dijeni : Debitorit, Shoqëria "ERNIKU" Sh.p.k me NIPT J71925004S**

**Per Dijeni : Kreditorit, Shoqëria "HAZIRI" Sh.p.k me NIPT J66702916G**

Unë, Florian Shehu, me detyrën e Përmaruesit Gjyqësor, pranë Shoqërise së Përmarimit Privat "TDR Group" Sh.p.k, në referim të Vendimit Për Vendosjen e Masës së Sigurimit Nr.1176 Akti, të lëshuar me Datë 14.01.2019 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë vendim, duke regjistruar në dosjen përmarimore Nr.1802/1, Datë 15.01.2019 kërkesën e kreditorit Shoqëria "HAZIRI" Sh.p.k me NIPT J66702916G me debitor Shoqëria "ERNIKU" Sh.p.k me NIPT J71925004S në lidhje me këtë vendim.

Për sa më sipër,

**KONSTATOJ**

Se me anë të Vendimit Për Vendosjen e Masës së Sigurimit Nr.1176 Akti, të lëshuar me Datë 14.01.2019 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur:

- Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur sekuestron konservative mbi sendet e luajtëshme dhe të paluajtëshme në pronësi të të paditurit Shoqëria "Erniku" Sh.p.k, për shumën e detyrimit principal në shumën 30,682,419 lekë dhe interesave në shumën 16,046,067 lekë, në të gjithë Bankat e Nivelit të Dytë, dhe/ose sende të regjistruara në regjistrat publik, Zyrë e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i vecantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të arsyetuar.
- U shpall në Tiranë sot me datë 14/01/2019.

Në këto kushte në referim të nenit 511 dhe 515 te Kodit te Proçedurës Civile,



Shoqëria Përmarimore Gjyqësore Private "TDR Group" sh.p.k  
Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr. 5 ,Kati i 11-të , Nr.54 Tiranë  
Tel : 00355 42 427790  
ëëë.tdr.al


## URDHËROJ

1. **Qendra Kombëtare e Biznesit - QKB** të kryej vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha kuotat dhe aksionet në pronësi të **Shoqërisë "ERNIKU" Sh.p.k me NIPT J71925004S** që zotëron në Shoqërinë "Bushttrica Energy 2009" Sh.p.k me NIPT K98505601E.
2. **Qendra Kombëtare e Biznesit - QKB** të kryej vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha kuotat dhe aksionet në pronësi të **Shoqërisë "ERNIKU" Sh.p.k me NIPT J71925004S** që zotëron në Shoqërinë "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k me NIPT K92227019N.
3. Të njoftohem dhe informohem menjëherë në lidhje procedurën e ndjekur nga Ju në lidhje me zbatimin e këtij urdhëri referuar Vendimit Gjyqësor të cilin po ja u dërgojmë bashkëngjitur.
4. Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Proçedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
5. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në Kodin e Proçedurës Civile, pala debitore mundet të paraqesë ankim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhëri.
6. Ky urdhër mbahet në disa kopje.

**SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "TDR GROUP" sh.p.k.**

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**FLORIAN SHEHU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
TIRANË

Nr. 1176 AKTI

**V E N D I M**  
**"PËR VENDOSJEN E MASËS SË SIGURIMIT"**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

**GJYQTARI: ALTIN SHKURTI**

Asistuar prej sekretares gjyqësore **ORNELA MARASHI**, në Tiranë sot me datë 14/01/2019, mori në seanvçë përegatitore çështjen civile Nr. 1176 Regj. Them. që i përket..

**PADITËS:** Shoqëria 'Haziri' Sh.p.k. me NIPT J66702916G, me përfaqësues ligjor Idriz Haziraj, me seli në Kukës, Gjinaj, Lagjia Haziraj, Rr. Nacionale Kukës-Gjinaj, Km. 5, me Nr. cel. 0672044075

**I PADITUR:** Shoqëria Erniku SH.P.k. me NIPT J71925004S me përfaqësues ligjor Iljaz Spahiu, me seli në Tiranë, Sheshi Rilindja, Qendra e Biznesit Karl Topia, Kulla nr. 3, Kati i III-të, me nr. cel. 0682023775

**OBJEKTI:** 1. Detyrimin e të paditurit shoqëria 'Erniku' Sh.pk. të përmbushi kushtet e Kontratës së Sipërmarrjes datë 10.12.2012 të nënshkruar midis Shoqërisë 'Harizi' sh.p.k. me cilësinë e sipërmarrësit dhe shoqërisë 'Erniku' sh.p.k. më cilësinë e porositësit, në shumën 30.682.419 lekë.

2. Detyrimin e të paditurit të shpërblejë dëmin e shkaktuar shoqërisë 'Harizi' sh.p.k. për shkak të mospërmbushjes së kushteve të Kontratës së Sipërmarrjes datë 10.12.2012 në formën e kamat vonesës ligjore të shumës së detyrimit të pakthyer në masën 30.682.419 lekë deri në ekzekutim të vendimit, detyrim i cili fillon pas 240 ditë kalenderike në kohën e përmbushjes së kontratës sipas aktit të ekspertimit.

3. Marrjen e masës së menjëhershme të sigurimit të padisë duke vendosur bllokimin me qëllim që mos të ketë të drejtë tërheqje në të gjitha bankat e nivelit të dytë në shumën e detyrimit principlialit në masën 30.682.419 lekë, pranë zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rugor.

**BAZA LIGJORE:** Neni 31, 32, 153, 154, Neni 202 e vijues të K.Pr.Civile dhe 419 e vijues, 445, 446, 450, 686 si dhe nenet 850 e vijues të Kodit Civil.



Gjykata në seancë përgatitore

**V Ë R E N:**

Paditësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi për detyrimin e të paditurit Shoqëria 'Haziri' Sh.p.k. të përmbushi kushtet e Kontratës së Sipërmarrjes datë 10.12.2012 të nënshkruar midis Shoqëria 'Haziri' Sh.p.k. me cilësinë e sipërmarrësit dhe shoqërisë 'Erniku' sh.p.k. me cilësinë e porositësit, në shumën 30.682.419 lekë. Detyrimin e të paditurit të shpërblejë dëmin e shkaktuar shoqërisë 'Harizi' sh.p.k. për shkak të mospërmbushjes së kushteve të Kontratës së Sipërmarrjes datë 10.12.2012 në formën e kamat vonesës ligjore të shumës së detyrimit të pakthyer në masën 30.682.419 lekë deri në ekzekutim të vendimit, detyrim i cili fillon pas 240 ditë kalenderike në kohën e përmbushjes së kontratës sipas aktit të ekspertimit. Marrjen e masës së menjëhershme të sigurimit të padisë duke vendosur bllokimin me qëllim që mos të ketë të drejtë tërheqje në të gjitha bankat e nivelit të dytë në shumën e detyrimit principlialit në masën 30.682.419 lekë, pranë zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor.


Në veprime paraprake gjykata konstaton se paditësi Shoqëria 'Haziri' Sh.p.k. ka kërkuar edhe marrjen e masës së menjëhershme të sigurimit të padisë duke vendosur bllokimin me qëllim që mos të ketë të drejtë tërheqje në të gjitha bankat e nivelit të dytë në shumën e detyrimit principlialit në masën 30.682.419 lekë, pranë zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor.

Paditësi pretendon me padinë në gjykim se i padituri shoqëria "Erniku" sh.p.k. ka nënshkruar një Kontratë Sipërmarrje me Bashkinë e Tiranës me Nr. 76/5 Prot., dt. 30.11.2012 me objekt 'Ndrëtimi i bulevardit Petro Nini Luarasi'.

Pas kësaj është nënshkruar një kontratë sipërmarrje dt. 10.12.2012 midis Shoqëria 'Haziri' Sh.p.k në cilësinë e sipërmarrësit dhe shoqërisë 'Erniku' Sh.p.k. në cilësinë e porositësit. Objekt i kësaj kontrate është marrja përsipër nga sipërmarrësi që të realizojë punimet për 'Ndërtimin e Bulevardit 'Petro Nini Luarasi', me vlerë 48,652,016 lekë pa TVSh, punime të cilat do të kryehen nga sipërmarrësi me celësa në dorë dhe për llogari të porositësit, kundrejt cmimit të caktuar në kontratë." Në nein 18 të saj është sanksionuar se kjo kontratë është hartuar në bazë të kontratës Nr. 76/5 Prot., dt. 31.11.2012 të Bashkisë Tiranë.

Paditësi pretendon se në vijim me nëshkrimin e kontratës me të paditurin, Shoqëria 'Haziri' Sh.p.k u angazhua të ndërtonte objektin duke e përfunuar atë përpara afatit të parashikuar në kontratë me dt. 08.06.2013, të saktësuar dhe në Akt Kolaudimin e rrugës. Kjo provohet me faturat tatimore të shitjes të Shoqëria 'Haziri' Sh.p.k Nr. 81, dt. 29.03.2013, Nr. 81/1, dt. 29.03.2013, Nr. 88, dt. 30.05.2013, Nr. 98, dt. 01.08.2013 Nr. 108, dt. 23.12.2013 të nënshkruar midis palëve ndërgjyqëse.

Paditësi pretendon se nga i padituri nuk është bërë likujdimi i detyrimit për shumat objekt kërkimi. Me padinë në gjykim paditësi i ka kërkuar gjykatës edhe marrjen e masës së sigurimit të padisë. Kjo kërkesë u rrëzua nga gjykata në veprime paraprake me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 7380, dt. 03.04.2018. Kjo kërkesë u ripërsërit nga paditësi edhe gjatë zhvillimit të seancave përgatitore dhe u rrëzua përsëri me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 7380, dt. 20.09.2018.







Për të provuar pretendimet dhe prapësimet e palëve ndërgjyqëse gjykata urdhëroi edhe kryerjen e akteve të ekspertimit kontabël nga ekspertja kontabël Ana Osmani dhe ekspertja ing. ndërtimi Liri Kruja.

Gjatë debatimit të tyre në seancën gjyqësore të datës 14.01.2019 paditësi riparaqiti klërkesën për vendosjen e masës së sigurimit. Paditësi pretendoi se kanë ndryshuar kushtet e vendosje së masë së sigurimit. Kështu nga ekspertja Ana Osmani me aktin e ekspertimit datë 05.09.2018 është vërtetuar ekzistencën e detyrimit. Po kështu pala e paditur ka marrë kredi në shumën 1.500.000 me një afat 5 vjecar dhe normë interesi 5 %. Kjo provohet me kontratën Linjë Kredie Nr. 986, dt. 31.08.2018 me Nr. 1897 Rep. 784 Kol., dt. 31.08.2018.

Paditësi pretendoi se po kështu i padituri po tjetëron asetet e tij. Midis shoqërisë Erniku sh.p.k. dhe shoqërisë Vëllazëria sh.p.k. është nënshkruar kontrata e shitjes dt. 03.08.2018 për shitje fabrike Asfalto Betoni në vlerën 1.500.000 lekë me TVSh. Ky akt është finalizuar me faturën tatimore të shitjes Nr. 50, dt. 03.08.2018. Ne kemi rënë në dijen të kësaj shitje pas lidhjes së kontartës së furnizimit Nr. 131 Rep. Dhe 88 Kol., dt. 10.01.2019. Në këto kushte i kërkojmë gjykatës që të mari masën e nsigurimit të padisë në bazë të nnein 202 të K.Pr.Civile.

Gjykata cmon se ligjvënsi ka parashikuar në nenin 202 e vijues të K.Pr.Civile se: “Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë”.

Gjykata cmon se ne interpretim te nenit 202 te KPC, që te konkludohet në caktimin ose jo të nje mase sigurimi padie, duhet e konstatojë ekzistencen e dy kushteve themelore:

- a) Ekzistencen e mundshme te nje te drejte per te cilen kerkohet mbrojtja, gjate procesit te gjykimit te padise, (e njohur ne doktrine si *fumus bani juris*);
- b) Ekzistencen e frikes qe ekzekutimi i vendimit per te drejten qe kerkohet te mbrohet do te behet i pamundur ose i veshtire (e njohur ne doktrine si *periculum in mora*).

a. Persa i perket kushtit te pare, kerkohet te provohet mundesia e ekzistences te se drejtes, pra verifikimi i nje probabiliteti te arsyeshem, pasi vertetimi i se drejtes eshte ceshtje e themelit. Ky vleresim i mundesise se ekzistences se te drejtes, behet ne baze te provave te paraqitura nga paditesi dhe qe do te duhet te vleresohen ne menyre siperfaqesore nga gjykata, sepse vleresimi perfundimtar mbi te cilat gjykata do te krijojë bindjen per themelin e padise, duhet t'i lihet gjykimit te themelit, ka nenvizuar Kolegji Civil i Gjykates se Larte Tirane ne dhenien e vendimeve nr. 479, date 27.10.2011, si dhe 370, date 05.10.2010. Ne kete konstekst, arsyeton ai kolegji, vleresimi gjyqësor i mundesise se sigurimit te padise, duhet te mbeshtet ne analizen e provave shkresore te cilat :

- 1) Parashtrojne fakte ne lidhje me marredhenien juridike objekt konflikti mes paleve;
  - 2) Mundesojne vleresimin nga gjykata te ekzistences se rrezikut, te pamundesise apo veshtiresise si rrezik i ekzekutimit te ardhshem te te drejtave te paditesit.
- b. Persa i perket kushtit te dyte, *periculum in mora*, ky kusht eshte i lidhur me: Rrezikun e ekzekutimit te vendimit te themelit Rreziku nga vonesa ne dhenien e vendimit te themelit.

1. Ne analize te trajtimit doktrinar ne reference krahasues me provat qe paditësi ka kerkuar te lejohen te shqyrtohen e administrohen ne gjykimin ne themel te mosmarreveshjes ne funksion te objektit te kerkimit te bere nga paditesi, plotesohen

te dy kriteret e parashikuara ne germat " a " dhe " b ", pasi:

-Ekziston e drejta, *fumus boni juris* per te cilen kerkohet marrja e mases provizore, pasi nepermjet provave te paraqitur nga palët dhe të marra nga gjykata në seancat përgatitore rezulton ekzistenca e një marrëdhënie juridike ndërmjet palëve e pa përmbushur; marrëdhënie që kërkohet të zgjidhet me vendim gjyqësor në cshtjen objekt shyrtimi.

-Ekziston rreziku i pamundesise se ekzekutimit te ardhshem i te drejtes se pales paditese, pasi ne bazë të veprimeve të kreyrea nga i padituri janë tjetërsuar asetet, Konkretisht midis shoqërisë Erniku sh.p.k.dhe shoqërisë Vllazëria sh.p.k. është nënshkruar kontrata e shitjes dt. 03.08.2018 për shitje fabrike Asfalto Betoni në vlerën 1.500.000 lekë me TVSh. Ky akt është finalizuar me faturën tatimore të shitjes Nr. 50, dt. 03.08.2018. Pas shitjes së kësaj fabrike nga i padituri paditësi ka lidhur kontratën e furnizimit Nr. 131 Rep. Dhe 88 Kol., dt. 10.01.2019 me blerësin shoqëria Vëllazëria. Shitja e asetëve si më sipër nga i padituri mund ta bëjë ekzekutimi e këtij vendimit për të drejtat e paditësit të pamundur ose të vështirë. Vlen të theskehohet se ky fakt nuk ka qenë në dijen të gjykatës në momnetin e rrëzimit si më sipër të kërkesës së paditësit për vendosjen e masave të sigurimit.

- Duke pasur parasysh sa më sipër gjykata cmon se ne rastin ne gjykim plotesohen ne menyre kumulitative te dyja kriteret e percaktuara ne germat " a " dhe " b " të nenit 202 të K.Pr.Civile, pasi me provat e paraqitura nga palet në gjykim rezulton ekzistenca e një marrëdhënie juridike ndërmjet palëve e pa përmbushur; marrëdhënie që kërkohet të zgjidhet me vendim gjyqësor në cshtjen objekt shyrtimi.

Nisur nga sa me siper, gjykata cmon se plotesohen kushtet e sipërcituara ligjore për marjen e masës së sigurimit të padisë. Kështu gjykat konkludon në vendosjen e sekuestros konservative mbi sendet e luajtëshme dhe të paluajshme në pronësi të të paditurit Shoqëria Erniku Sh.p.k., për shumën e detyrimit principlial në shumën 30.682.419 lekë dhe intersave në shumën 16.046.067 lekë, në të gjithë Bankat e Nivelit të Dytë, dhe/ose sende të regjistruara në regjirat publik, Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata duke u bazuar në nenet 202 e vijues të K.Pr.Civile.

#### **VENDOSI:**

- Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur sekuestron konservative mbi sendet e luajtëshme dhe të paluajshme në pronësi të të paditurit Shoqëria Erniku Sh.p.k., për shumën e detyrimit principlial në shumën 30.682.419 lekë dhe intersave në shumën 16.046.067 lekë, në të gjithë Bankat e Nivelit të Dytë, dhe/ose sende të regjistruara në regjirat publik, Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor,

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i vecantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 05 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

- U shpall në Tiranë sot me datë 14/01/2019

**SEKRETARE**

**ORNELA MARASHI**

